

PROCESVERBAL-Tipi I kontratës-Sherbim
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky proces verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: Studim Projektimi i objektit “Ndërtim i rrjeteve të ujesjellesit te Fshatrave Buqeze, Piskupat, Memlisht, Grunjas dhe Lagjja Lumi Terhanit, Bashkia Pogradec”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(CPV):

22114311-5 Projekte

VLERA E FONDIT LIMIT:

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **2.473.686,42 (dy milion e katerqind e shtatedhjet e tre mijë e gjashteqind e tetdhjet e gjashte pike dyzet e dy) leke pa t.v.sh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” (të ndryshuar), nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Afati i shërbimeve do të jetë për një periudhë **30 ditore ose 1 muaj**

Në zbatim të urdhrit të grupit të specifikimeve, të Titullarit të Autoritetit Kontraktor, "Mbi Përgatitjen e Specifikimeve Teknike dhe Përlllogaritjen e Vlerës Limit për objektin e mësipërm, të planifikuar për t'u kryer në programet e investimeve.

Grupi i specifikimeve teknike pasi u njoh me objektin e prokurimit, programoi punën për përlllogaritjen e vlerës së projektit dhe hartimit të specifikimeve teknike duke u mbështetur në këto dokumenta:

- VKM. Nr. 354, datë 11.05.2016 "Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim".

PËRLLLOGARITJA E VLERËS LIMIT TË KONTRATËS

Për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, mbështetur në Ligjin Nr.162 date 23.12.2020"Për Prokurimin Publik", dhe VKM, Nr 285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", sipas të cilit:

Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave(INSTAT), ose/dhe çmime tjetëra zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shëmbull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtise, ne manuale eti): ose/dhe:

- a. çmimet e tregut; ose/dhe
- b. çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore:ose/dhe çmimet ndërkombetare, të botuara.

Për llogaritjen e vleres së projektit grupi i punës, siç edhe është theksuar më lart është mbështetur në Vendimin VKM. Nr. 354, datë 11.05.2016,(bashkelidhur detyra e projektimit)

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

OFERTUESI DEKLARON SE:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendim i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi;
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përfshirë nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi;
- j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;
- k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas **Shtojcës 10**.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

- Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.
- Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës”, të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik: citojmë Neni 83 i LPP “Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, mepërfshirë të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, Operatori Ekonomik duhet të plotësojë kërkesat ligjore sipas pikës 1 të Shtojcës 9 të DST.

Shënim:Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar

Në lidhje me përcaktimet në VKM Nr.285/2021 për miratimin e rregullave të prokurimit publik",neni 45 ku kërkohet "Në rastin kur oferta ekonomikisht më e favorshme identifikohet në bazë të kostos,autoriteti ose enti kontraktor duhet të argumentojë dhe të dokumentojë vendosjen e çdo kriteri që do të përdorë,si dhe peshën specifike për secilin kriter,konkretisht,pikët që do të ketë çdo kriter dhe mënyrën e llogaritjes së pikëve për ofertuesit e një pasnjëshëm.,vlerësojmë si më poshtë:

Së pari në DST **Kapitulli 4.4**"Kriteret e përzgjedhjes së fituesit" Autoriteti Kontraktor gjykoj që të vlerësohet mbi bazën e Ofertës ekonomikisht më e favorshme,bazuar në kosto **X**

Sipas rëndësisë:

Çmimi

☐ **pikët 50**

Propozimi Teknik

☐ **pikët 50**

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

Kriteret e Vlerësimit

Pikët

(i) Përvoja për Punë të Ngjashme të operatorit ekonomik [0-10]

Nënkriteret

i/a Përvoja për punë të ngjashme 40-80%

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

i/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

(ii) Metodologjia e Propozuar [20-60]

Nënkriteret

ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia [20-30%]

ii.b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit [30-40%]

ii.c. Organizimi i Stafit [20-30%]

ii/a. Përqasja teknike dhe metodologjia: Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përqasjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e ndryshme, duke përfituar rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përqasjen teknike që do të adaptojë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërqasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit: Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përqasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

ii/c. Organizimi dhe Stafit: Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomiko-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

(iii) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar [10-30]

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm [5-20%]

b- Eksperienca në fushën përkatëse [30-80 %]

- Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.
- Eksperienca në fushën përkatëse përfshin: eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

Nëse transferimi i njohurive nuk aplikohet (nuk kërkohet), atëherë pikët maksimale të parashikuara për vlerësimin e këtij kriteri duhet t'i shtohen kriterit "Kualifikimet e Stafit kryesor të propozuar".

Vlerësimi përfundimtar

Peshat për Propozimet Teknike dhe Financiare janë dhënë si më poshtë:

Pesha për Propozimin Teknik: $X = (\text{pikët e propozimit teknik} \times 0.5)$

Pesha për Propozimin Ekonomik: $Y = (\text{pikët e propozimit ekonomik} \times 0.5)$

Oferta më e mirë do të jetë sipas kombinimit të pikëve të propozimit teknik dhe propozimit ekonomik. Formula e llogaritjes është si më poshtë:

Oferta më e mirë = $X + Y$

Argumentimi :Duke marrë në konsideratë natyrën e kontratës si shërbim projektimi autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin “oferta ekonomike me e favorshme bazuar në kosto në mbështetje të nenit 45 të vkm nr 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar Ndarja e pikeve 50 pike cmimi me 1 ulës dhe 50 pike propozimi teknik garantojnë një balance midis cilesisë dhe koston, duke siguruar një projekt me zgjidhje teknike të standarteve të larta dhe një cmim konkurrues. Piket për çdo kriter janë vendosur sipas rendesise

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros minimale për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se (989 474.56) leke) leke 40% të vlerës së parashikuar të kontratës objekt prokurimi.

2. Operatori ekonomik duhet të paraqesi kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2022, 2023, 2024) të paraqitura në autoritet përkatës, Dega e Tatim Taksave, të konfirmuara nga ky autoritet, ku të paktën në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar sipas vlerës së fondit limit të kësaj procedure, sipas nenit 77, pika 3, të ligjit nr. 162/2020, si dhe neneve 43 dhe 47, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me qëllim që autoriteti kontraktor të kuptojë nëse operatorët ekonomikë ofertues kanë apo zotërojnë mundësitë e nevojshme financiare për të përmbyllur punët publike me sukses. Xhirot e tre viteve të fundit janë 2022, 2023 dhe 2024, që rezulton të jenë përmbyllur edhe sipas legjislacionit tatimor. Përqindja e kërkuar mbi xhiron vjetore është një përqindje minimale sipas RRPP-ve dhe xhiro e tre vjetëve e kërkuar, jo vetëm që përputhet me praktikën administrative të prokurimeve publike të ndjekur deri më tani, por është e rëndësishme për të vlerësuar kapacitetin ekonomik të ofertuesit dhe kuptuar nëse është i aftë financiarisht për të përmbyllur punët publike pranë autoritetit kontraktor.

Po kështu, që nga operatorët ekonomikë të vërtetohet kapaciteti ekonomik, ata mund të paraqesin kopje të bilanceve të tre viteve të fundit për vitet 2022, 2023, 2024, si mbas xhirove vjetore, të depozituar pranë autoriteteve përkatëse tatimore, të konfirmuara nga ky autoritet, sipas ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar. Paraqitja e bilanceve është një mundësi, në rast se operatori ekonomik ofertues paraqet xhirot e kërkuara. Këto kërkesa të vendosura në DST (për mundësinë e paraqitjes së bilanceve dhe detyrimin e paraqitjes së dokumenteve për xhiron vjetore) përputhen edhe me nenin 9 të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe ligjin nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe kontabilistit të miratuar”, të ndryshuar, sipas të cilëve periudha e raportimit financiar është 12 muaj dhe periudha e depozitimit të pasqyrave financiare është nga 12-15 muaj. Të gjitha kërkesat lidhur me kapacitetin ekonomik janë të bazuara në legjislacionin e përmendur më sipër dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse ofertuesit kanë kapacitete për të nisur dhe përfunduar punët publike që prokurohen. Po kështu, duke qenë se mund

të marrin pjesë si ofertues edhe bashkime operatorësh ekonomikë, atëherë secili prej operatorëve ekonomikë të bashkuar, duhet të depozitojë dokumentacionin si më lart.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke i'u referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore e të ardhurave: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”;si dhe shkronjës c, të nenit 41 të ligjit nr. 10091, datë 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, ku parashikohet se:”Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: ... c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur,

në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii. ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël.”. Po kështu, kjo kërkesë bazohet edhe në udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë shërbime të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë jo më të vogël se (989 474.56) 40% e fondit limit të objektit të prokurimit, të realizuara gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me entet publike, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur kontratën e nënshkruar me entin publik, të shoqëruar me vërtetimin e lëshuar nga Autoriteti Kontraktor për realizimin e plotë dhe të suksesshëm të kësaj kontrate, ku të jetë e përcaktuar kohëzgjatja e shërbimit, vlera e shërbimit të realizuar ,si dhe faturat tatimore përkatëse të shitjes sipas legjislacionit në fuqi/ ose
- b) Kur shërbimi i ngjashëm është realizuar me sektorin privat, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore përkatëse të shitjes *(ku të shprehen qartë datat, shumat dhe shërbimet e realizuara)*.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi:Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 40 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose në vlerën limit të kontratës për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Këto vlera janë vlerat minimale të kërkuara sipas RRPP-ve.

a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratën e shërbimit; vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës; Situacion Përfundimtar dhe faturat tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor.

b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë Kontratë Shërbimi dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, i shërbejnë autoritetit kontraktor

për të kuptuar nëse ofertuesi ka qenë i angazhuar në veprimtari ndërtimore të ngjashme pranë subjekteve private, i ka përmbyllur me sukses këto punë, si dhe ka kapacitet teknik për të përmbyllur punët që prokurohen nga autoriteti kontraktor. Dokumentet e mësipërme janë të mbështetura edhe në legjislacionin në fuqi të zbatueshëm për ndërtimet.

Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet, që ka marrë përsiper të kryejë secili anëtar i BOE. Kjo kërkesë bazohet në nenet 88 e në vijim të LPP.,

2.3.2 Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Liçensa profesionale të shoqërisë (e vlefshme) për projektim (lëshuar nga Institucioni i Autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për dhënien e licensave profesionale në fushën e studimit e projektimit në ndërtim), ku të përfshihen kategoritë:

- 3 a, Objekte civile - industriale - turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate.
- 4 b, Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimit, si dhe impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme
- 5c, Projektim Ujesjelles Kanalizime Urbane dhe rurale
- 8 a, Rilevime inxhinierike.
- 8 b, Rilevime inxhinierike kadastrale
- 8d, Bazamente gjeodezike
- 9a Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit për objekte civile-ekonomike deri 5 kate.
- 9 d, Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qendrueshmeri të ulët

Sqarim: Për licencat e lëshuara pas hyrjes në fuqi të Vendimit nr.943, datë 28.12.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave ‘Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e kolaudit të punimeve të zbatimit në ndërtim”i ndryshuar me VKM. Nr. 943 date 28.12.2016. Ofertuesit duhet të sjellin Liçencat e rinovuara në zbatim të këtij vendimi.(Për Operatorët e huaj të bëhet njehsimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë institucionit përkatës, në plotësim të licensave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës).

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet si më poshtë:

KATEGORIA E KËRKUAR	PËRSHKRIMI I KATEGORISË	ARGUMENTIMI
3. a	Projektim objekte civile-industriale-turistike prej murature e skelet beton arme deri në 5 kate	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyres së Projektimit është përcaktuar kategoria e licensave e cila parashikon kryerjen e shërbimeve të lidhura kryesisht me projektimin e objekteve civile (depo uji) dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. Meqenese depot e ujit janë me strukture beton arme, nevojitet pika e mesipërme, kryesisht në fshatin Grunjas, Memelisht
4.b	Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimit, si	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyres së Projektimit është përcaktuar kategoria e licensave e cila parashikon kryerjen e shërbimeve të lidhura me projektimin e linjave elektrike të objekteve civile (depo uji Grunjas, Memelisht,) ku të rendesishme janë funksionimi i pompave të klorit, klorinimi automatik, furnizimi i objekteve dhe afrimi i linjës furnizuese. Gjithashtu dhe si rrjedhojë

	dhe impianteve te prodhimit te energjise termike nga burime te rinovueshme	gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara
5.c	Projektim Ujesjelles Kanalizime Urbane dhe rurale	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyres se Projektimit parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura kryesisht me projektimin Projektim ujesjellesi per zonat rurale, kryesisht per fshatrat Buqeze , Piskupat, Memlisht, Grunjas, Lagja lumi Terhanit.
8. a	Rilevime inxhinierike.	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyres se Projektimit parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura me rilevimet inxhinierike te objekteve civile (depo uji, kaptazhet, rrjet shperndares) , dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.
8.b	Rilevime inxhinierike kadastrale	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyres se Projektimit parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura me rilevimet inxhinierike te objekteve civile (depo uji, kaptazhet, rrjet shperndares) , dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. Per linjat apo depot , kaptazhet , duhet nje studim dhe nje percaktim ne lidhje me pronesite ku do shtrihen linjat duke percaktuar vendodhjen e sakte te tyre, pra te percaktohet pronesia ose mundesia per shpronetim.
8.d	Bazamente gjeodezike	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyres se Projektimit parashikohet kryerja e shërbimeve te lidhura me rilevimet inxhinierike te objekteve civile (depo uji, kaptazhet, rrjet shperndares) , dhe si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara.Per percaktimin e kuotave ne burim, ne depo dhe pergjate linjes si dhe pikat e lidhjes me abonentet per te gjithë fashtrat ku shtrihet projekti.
9. a	Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte civile-ekonomike deri 5 kate	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyres se Projektimit parashikohet kryerja e shërbimeve Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte civile-ekonomike deri 5 kate. (depot e ujit) , si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. Per studimin e shtresave te tokes mbi te cilat do vendosen themelet e depove , qe do te ndertohen ne fshatrat Grunjas dhe Memelisht , si dhe shtresat ne zonen e burimeve.
9.d	Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i trojeve te buta dhe shpateve me qendrueshmeri te ulet	Bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Detyres se Projektimit parashikohet kryerja e shërbimeve Studim/Vleresim gjeologo-inxhinierik i truallit per objekte civile-ekonomike deri 5 kate. (kaptazhet) , si rrjedhojë gjykohet që kjo pikë është e nevojshme për realizimin me sukses të shërbimeve të kërkuara. Per studimin e shtresave te tokes mbi te cilat do vendosen themelet e kaptazheve , qe do te ndertohen ne fshatrat Grunjas dhe Memelisht , Buqeze si dhe shtresat ne zonen e burimeve.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të ketë Drejtuesit Teknikë të Përfshirë në Licencën e Shoqërisë, si më poshtë, vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, licensë profesionale individuale, CV, librezë pune dhe të listuar në listpagesat e Shoqërisë për periudhën muajin e fundit nga data e zhvillimit të procedurës:

- 1 (nje) Projektues inxhinier Ndertimi Profili Strukturist /konstruktor
- 1(nje) Projektues inxhinier Gjeodet
- 1(nje) Projektues inxhinier Gjeolog
- 1(nje) Projektues Vepra Hidroteknike
- 1(nje) Projektues Inxhinier Elektrik

Shënim:Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshmërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Operatori/ët ekonomik duhet të dëshmojë që ka stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin e suksesshëm të kontratës bazuar në neni 77, pika 4, të Ligjit 162/2020, “ Për prokurim publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma b, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Njësia e prokurimit për vendosjen e stafit i është referuar Detyres se Projektimit për këtë objekt pjesë e kësaj procedure, pjesë e secilave do të jenë të licensuar për shërbimet që priten të realizohen.

Më konkretisht, po paraqesim argumentimet për inxhinieret si më poshtë:

Për realizimin e këtij studim projektimi objekti nevojitet një ekip inxhinieresh të udhëhequr nga **Drejtuesite Projektit** që kanë detyra kryesore të lidhura me kryesisht me drejtimin dhe kordinimin e ekipit të inxhinierëve të stafit, drjetimin e aktiviteteve kryesore për realizimin e shërbimeve, prodhimin e dokumentave kryesore si dhe raporteve që kerkohen sipas Detyre se Projektimit, si dhe mbajtjen e kontakteve me autoritetin kontraktor.

Projektues Inxhinier Ndertimi Profili Strukturist/konstruktor pasi ky profil është domosdoshme dhe pershtatet me shërbimet e kërkuara për projektimin e ndertesave civile. Në rastin konkret kemi të bëjmë me projektimin e e depove në fshatrat Grunjas dhe Memelisht . Inxhinier struktursit/konstruktor është shumë i domosdoshme për realizimin e llogaritjeve inxhinierike dhe projektimin e të gjitha strukturave, kolonave etj me qëllimin që vepra njëkohesisht të jetë funksionale dhe të ofrojë siguri maksimale.

Projektues Gjeodet, kerkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me azhornimin topografik të terrenit egzistues dhe të gjithë hapesires ku mendohet të ndertohen , pra vendodhjen e depove të ujit, kaptazheve dhe linjave të transmetimit kundrejt abonenteve .

Projektues Gjeolog, kerkohet për realizimin e shërbimeve të lidhura kryesisht me studimet gjeologjike të tokës ku do të ndertohet objekti, kaptazhe dhe depot , hartimin e relacionit gjeologjik.

Projektues Vepra Hidroteknike , meqenëse ndertimi i depove dhe rrjetit të shpërndarjes është proces kompleks , por kryesisht është veper e mirfillte hidroteknike, duhen përcaktuar përrllogaritjet hidraulike të rrjetit të shpërndarjes, reduksionet rregullatoreve të presionit dhe të gjitha nyjeve të rrjetit, është mese e nevojshme pjesëmarrja e projektuesit hidroteknik.

Projektues Inxhinier Elektrik Punimet për shërbimin e projektimit të sistemeve elektrike që do të furnizojnë me energji depot e reja në fshatrat Grunjas, Memelisht për funksionimin e pompave të klorinimit dhe furnizimin e objektit me energji si dhe afrimin e linjes furnizuese të transmetimit të energjisë..

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të kenë në Stafin e Shoqërisë ose të kontraktuar me kontratëpunë / shërbimi për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës, Personel të kualifikuar/certifikuar si:

- a) 1 (një) punonjës të pajisur me certificate lëshuar nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, Diplome/certificate.

Shënim:Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t`u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi:Ekspert mjedisor për hartimin e VNM është i nevojshëm për hartimin e raportit të Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) sipas përcaktimeve të termave të referencës.

Ky kriter është vendosur gjithashtu në përputhje me Ligjin Nr. 10 440, datë 7.7. 2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” të ndryshuar në pikën 18 të nenit 6 të të cilit është është parashikuar se:

“Ekspert i certifikuar i VNM-së” është personi fizik, i cili pajiset me certifikatën përkatëse nga ministria, për hartimin e raportit të VNM-së, ekspertizën mjedisore dhe auditimin mjedisor dhe pikën 3 të nenit 6 të këtij ligji është parashikuar se:

“Vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM)” është procesi që kryhet për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis nga projekte të propozuara publike ose private nëpërmjet:

a) përgatitjes së raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga zhvilluesi;

b) kryerjes së konsultimeve sipas kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në kreun III të këtij ligji;

c) shqyrtimit nga autoriteti kompetent të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis dhe të çdo informacioni tjetër shtesë nga zhvilluesi, kur është i nevojshëm, si dhe të çdo informacioni tjetër të rëndësishëm, marrë nëpërmjet procesit të konsultimeve;

ç) përfundimit të arritur, të arsyetuar nga autoriteti kompetent, për ndikimet e rëndësishme në mjedis të projektit, duke marrë në konsideratë rezultatet e shqyrtimit të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis nga autoriteti kompetent dhe kur është e përshtatshme shqyrtimin e vet shtesë;

d) përfshirjes në vendimin e miratimit të zhvillimit të projektit nga autoriteti përgjegjës për miratimin e zhvillimit të përfundimeve të arritura të arsyetuara nga autoriteti kompetent.”

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat sipas Standarteve ISO, të vlefshme (ose ekuivalente), si me posht

- EN-ISO 14001:2015 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- EN- ISO 9001-2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësive) ose ekuivalent
- EN-ISO 45001:2023 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

Te gjitha certifikata e mesiperme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit.

Nese ofertuesi do te paraqitet si bashkim operatoresh, certifikatat duhet te jene ne perputhje me punimet e marra persiper.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në nenin 44“Kërkesat e cilësisë”të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 përcaktohet:“Autoriteti/entikontraktor,për të vërtetuar se punët,mallrat ose shërbimet,objekt prokurimi,i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin **çertifikata të** lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë,vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.”

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë,standartet për shëndetin dhe sigurinë në punë si dhe standarde te menaxhimit të mjedisit.

Në mbështetje të përcaktimeve ligjore dhe nën ligjore të sipërcituara,Autoriteti Kontraktor vlerëson se:

Autoriteti Kontraktor gjykon se operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të plotësojnë kërkesa te standarteve në lidhje me garantimin e cilësisë së punimeve objekt kontrate në mënyrë të qëndrueshme, ku referuar natyrës së punimeve që kërkohen të kryhen,jane kërkuar certifikatat e mësipërme për vërtetimin se operatorët ekonomikë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për këto punime.

Komisioni përcaktoi kriteret si më lart duke qenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Por edhe sepse mbi të gjitha ato i shërbejnë Autoritetit tonë Kontraktor për njohjen e aftësisë profesionale,organizative,reputacionin dhe besueshmërinë e operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Konkretisht **Certifikatë ISO 9001 - 2015** “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, mundëson që shoqëria të punojë me standarte e cilësi e cila mundëson implikimin në menaxhim, identifikimin e riskut dhe mundësive,sigurimin e konkurrencës përpersonelin e shoqërisë,mirëmbajtja e pajisjeve dhe infrastrukturës,etj.

Certifikatë ISO 45001-2023 “Për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë” mundëson që çdo kompani duhet të mbrojë shëndetin dhe sigurinë në punë për të gjithë punonjësit, e cila përfshin vlerësimin e rreziqeve të aksidenteve në punë, vendosjen e masave në fushën e shëndetit dhe sigurisë, inkurajimin e pjesëmarrjes së punonjësve në përpjekjet për të përmirësuar kushtet e punës,zbatimin e masave për të zvogëluar rreziqet e aksidenteve dhe sëmundjeve si dhe hetimin e incidenteve.

Certifikatë ISO 14001-2015 “Për sistemin e menaxhimit te mjedisit” është kërkuar me qëllim vërtetimin e aftësisë së operatorit ekonomik për marrjen e masave të nevojshme mjedisore ndaj dëmtimit të mjedisit kontrolluar duke minimizuar aq sa lejon sistemi, ku gjatë ushtrimit të veprimtarisë nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis, si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra, ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.Certifikatat e cilesise jane bazuar ne perputhje me objektin e zbatimit qe do te mbikëqyret dhe jane ne perputhje me natyren dhe objektin e kontrates qe prokurohet.

2.3.6 Ofertuesi duhet të ketë në pronësi ose me qera Pajisjet Gjeodezike si më poshtë:

- **1 (nje) pajisje GPS**
- **1(një) Pajisje Total Station**
- **1(nje) Dron**

Në lidhje sa më sipër operatori ekonomik duhet të paraqesë: Faturë shitblerje ose kontratë qeraje të noterizuar (shoqëruar me dokumentat e pronsisë së qeradhënësit origjinal ose fotokopje e noterizuar) si dhe skedën teknike.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse do të jetë nevoja për t'u kërkuar sqarime nga AK.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit.

Pajisje Total Station dhe GPS kerkohen per te kryer matjet topografike dhe rilevimet qe lidhen me sherbimin e projektimit te ndertimit te objektit te prokurimit .

Droni per paraqitjen e zonava ne ortofoto si dhe per planifikim te sakte te rrjetit te shperndarjes.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Detyrat e projektimit janë hartuar nga stafi inxhinierik i Shoqërisë Rajonale Ujesjelles Kanalizime Pogradec sh.a .

Komisioni

Ferdinant Kulloli (Specialist fushe, kryetar)

Albert Tavanxhiu (Specialist Fushe, antar)

Arber Collaku (ekonomist, antar)

